

STATUTI
SHOQERI ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR

"St. Luis Watersports" Sh.p.k

Ne kete Statut / Akt Themelimi

Baza Ligjore: Ligji Nr.9901, dt 14.04.2008 "Per Tregtarët dhe Shoqeritë tregtare" i ndryshuar.

Statuti eshte Statuti i shoqerise.

Ne Durres,sot me date 05.Korrik 2023, ortaku themelues i shoqerise

"St. Luis Watersports"sh.p.k

Z.Luis Xhumari, i datelindjes 16.02.1969 ,lindur ne Shqiperi e banues ne Durres, shtetas Shqiptar, madhor, dhe me zotesi juridike per te vepruar, identifikuar me karte identiteti me numer G90216073N.

Me vullnet të plotë e te lire, mbështetur :

Në Kushtetuten e Republikës së Shqipërisë dhe Kodin Civil në fuqi,

Në ligjin 9901 datë 14.04.2008, " Per Tregëtarët dhe Shoqërite Tregëtare,

Në ligjin "Për Qendrën Kombëtare të Biznesit" në atë Doganore, Fiskal e Tatimor, ka themeluar Shoqërinë tregtare me pergjegjesi te kufizuar me emrin "St. Luis Watersports"sh.p.k: (më poshte e quajtur "shoqëri).

KREU I

NENI 1

Krijimi

Shoqëria "St. Luis Watersports"sh.p.k është person juridik i të drejtës shqiptare, Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar.

NENI 2

Personaliteti juridik

Shoqëria fiton personalitetin juridik pasi të jetë rregjistruar në QKB; në përputhje me kushtet dhe procedurat e parashikuar ne ligj

Shoqëria "St. Luis Watersports"sh.p.k është një shoqëri tregtare, e themeluar nga ortaku i vetem i shoqerise Z. Luis Xhumari, i cili përgjigjen për detyrimet e shoqërisë tregëtare dhe

mbulojne personalisht humbjet e shoqërisë deri ne pjesën e pashlyer të kontributeve të nënshkuara. Kontributi i ortakëve përbën kapitalin e rregjistruar të shoqërisë .



NENI 3

Scila

Shoqëria e ka selinë në Lagjja nr.13, Plazh, objekt me nr.pasurie 60/94/ND+2-58, Zona Kadastrale 8518 Durres. Shoqëria mund të ndryshoje selinë e saj , te hapë zyra përfaqësie, degë, të krijoj filiale, si brenda dhe jashtë vendit Republikës së Shqipërisë , vetëm me vendimin e Ortakut themelues .

NENI 4

Objekti i veprimtarisë

Operator Turistik. Aktivitete Sportive Ujore.

NENI 5

Kohëzgjatja

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj për një periudhë kohore të papërcaktuar, duke filluar nga data e regjistrimit në QKB.

KREU II

KAPITALI

NENI 6

Kapitali themeltar

Kapitali themeltar i shoqërisë është 100.000 (njëqind mijë) leke, i ndarë në 1 kuotë me vlerë nominale 100.000 (njëqind mijë) leke, i nënshkruar plotësisht nga ortaku vetëm themelues në masën 100%. Pjesët e kapitalit themeltar nuk mund të përfaqësohen nga letra me vlerë të tregëtueshme. Kontributi i ortakut mund të jetë në para ose në natyrë (pasuri të luajtshme të paluajtshme apo të drejta). Ortaku i vetëm përgjigjet për humbjet e shoqërisë përkundëjt të tregëtve deri në vlerën e kontributit të kapitalit themeltar të shoqërisë

Pjesët e kapitalit themeltar nuk mund të përfaqësohen nga letra me vlerë të tregëtueshme. Kontributi i ortakëve mund të jetë në para ose në natyrë (pasuri të luajtshme / të paluajtshme apo të drejta). Ortaket përgjigjen për humbjet e shoqërisë përkundëjt të tregëtve deri në vlerën e kontributit të kapitalit themeltar të shoqërisë.



NENI 7

Zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit

Kapitali i shoqërisë mund të zmadhohet nëpërmjet nënshkrimit të pjesëve të kapitalit themeltar për kontributet në para dhe me anë të kontributeve në natyrë, dhe në shërbime, nëpërmjet emërimit nga gjykata kompetente e një eksperti të autorizuar për këto kontribute në natyrë sipas kërkesës së administratorit.

Zvogëlimi i kapitalit realizohet me vendimin e Asamblese se ortakeve të shoqërisë në të njëjtat kushte që kërkohen për ndryshimin e statutit. Projekti i zvogelimit të kapitalit u komunikohet ekspertëve kontabël të autorizuar, në rast se ka të tillë të paktën 45 ditë përpara datës së mbledhjes së Asamblesë së Ortakeve të thirrur për të marrë vendim rreth këtij projekti. Zvogëlimi i kapitalit themeltar në një vlerë më të vogël se ajo e përcaktuar në nenin 6 të këtij statute, e bën të detyrueshëm marrjen e një vendimi prej shoqërisë për zmadhimin e kapitalit themeltar të paktën deri në vlerën minimale. Në rast moszbatimi të kërkesave të këtij paragrafi, çdo person i interesuar mund të kërkojë në rrugë gjyqësore prishjen e shoqërisë. Kjo prishje nuk mund të shpallet, në qoftë se rregullimi është bërë në ditën kur gjykata mblidhet për të marrë vendimin.

NENI 8

Transferimi kapitalit

Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo të kalohen nëpërmjet :

- a) Kontributi në kapitalin e shoqërisë,
- b) Shitblerjes,
- c) Trashëgimisë,
- d) Dhurimit,
- e) Çdo mënyrë tjetër të parashikimit në ligj,

Në rastin e kalimit me kontratë, kontrata duhet të behet me shkrim.

Personi që kalon kuotën dhe personi që e fiton atë përgjigjen në mënyrë solidare, ndaj shoqërisë për kalimin e saj në Qendren Kombetare të Rregjistrimit, sipas nenit 43 të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 "Për Qendren Kombetare të Biznesit". Rregjistrimi kalimit të kuotave ka efekt deklarativ.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme me rrugë trashëgimie.

KREU III

ORGANET VENDIMMARRESE DHE DREJTUESE

NENI 9

Organi Vendimmarrës



Asambleja e ortakeve është organi i vetem i vendimëmarrjes i shoqërisë. Asambleja e ortakeve është organi vendimëmarrës i shoqërisë që miraton çdo ndryshim të statutit sipas modaliteteve të përcaktuara në ligj. Çdo ndryshim statuti duhet të depozitohet pranë QKR për të pasqyruar ndryshimet në skedën e shoqërisë.

Asambleja e ortakeve, vendos për ceshtje si :

- a) Përcaktimi i politikave tregëtare të shoqërisë ;
- b) Emërimin dhe shkarkimin e administratorëve
- c) Emërimin dhe shkarkimin e likujduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- d) Përcaktimin e shpërblimeve
- e) Mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregëtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe raporteve të ecurisë së veprimtarisë ;
- f) Përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratoreve
- g) Miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesës ;
- h) Të gjitha vendimet e marra nga asambleja e ortakeve rregjistrohen në një regjister të vendimeve, të dhënat e të cilit nuk mund të ndryshohen ose të fshihen .duhen rregjistruar ne vecanti, por pa u kufizuar në to, vendimet për;
- i) Miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe tëq raporteve të ecurisë së veprimtarisë
- j) Shpërndarjen e fitimeve vjetore dhe mbulimin e humbjeve ;
- k) Investime
- l) Vendimet per riorganizimin dhe prishgjen e shoqërisë

Vendimet e parregjistruar ne regjistrin e vendimeve janë absolutisht të pavlefshem. Shoqëria nuk mund ti kundërdrejtoj pavlershmërinë e te tretit , që që ka fituar të drejta në mirëbesim, përvec rastit kur shoqëria provon se i treti ka pasur dijeni për pavlershmerin, apo në bazë të rrethanave të qarta nuk mun të kishte pasur dijeni për të.

NENI 10

Administrimi

(1)Asambleja e pergjithshme e Ortakut te vetem emerone **Z.Luis Xhumari dhe Znj.Eriselda Meta**,si administratore te shoqerise. Afati i emerimit eshte 5 vjet me te drejte ripërteritje. Emerimi i administatoreve prodhon efekte pas regjistrimit ne Qendren Kombetare Te Regjistrimit.

(2)Administratoret e nje shoqerie tragtare meme, sipas percaktimit te nenit 207 te ketij ligji, nuk mund te emerohen si administratore te nje shoqerie te kontrolluar e anasjelltas.

Çdo emerim i bere ne kundërshtim me keto dispozita eshte i pavlefshem.

(3) Personat e meposhtem caktohen si Administratore te pare te shoqerise deri ne emerimin e tyre nga mbledhja e pare e Asamblese se Pergjithshme.



Administratoret e shoqërisë:

Z.Luis Xhumari i biri i Jani dhe i Anes lindur ne Tirane dhe banues ne Durres, shtetas Shqiptare, madhor, dhe me zotesi juridike per te vepruar, identifikuar me karte identiteti me numer G90216073N.

-Administratori Luis Xhumari do te kete tagrin me te gjitha kompetencat per drejtimin e nje shoqërie me pergjegjesi te kufizuar.


Specimenti i nenshkrimit



Znj.Eriselda Meta e bija e Skender dhe e Dhurates e datelindjes 14.12.1997 lindur ne Gramsh dhe banues ne Durres, me nr karte Id J76214007W, madhor me zotesi juridike per te vepruar.

Administratori Eriselda Meta do te kete tagrin me kompetenca si perfaqesues ligjor dhe drejtues teknik i shoqërisë.

Specimenti i nenshkrimit



NENI 11

Kompetencat

Administratori ka të drejtë e detyrohet të :

- a) Kryeje të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregëtare të shoqërisë , duke zbatuar politikat tregëtare , të vendosura nga asambleja e përgjithëshme;
- b) Perfaqësoj shoqërinë tregëtare ;
- c) Kujdeset për mbajtjen saktë e të rregullt të dokumentave dhe librave kontabel të shoqërisë ;
- d) Përgatisë dhe nënshkruajë bilancin vjetor , bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shperndarjen e fitimeve , I paraqesin këto dokumenta përpara asamblesë së përgjithëshme për miratim;
- e) Krijojë një system paraljmërimi në kohën e duhur për rrethanat që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe egzistences së shoqërisë
- f) Kryeje rregjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, sic parashikohet ne ligjin për Qendren Kombetare të Rregjistrimit.



- g) Raportoj përpara asamblesë së përgjithëshme në lidhje me zbatimin e politikave tregëtare dhe me realizimin e veprimeve të posacme me rëndësi të vecantë për veprimtarinë e shoqërisë tregëtare ;

Administratoret janë të detyruar të thërrasin mbledhjen e ortakëve në rastet kur :

Sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetvë financiare , rezulton ose ekziston rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme Brenda 3 muajve në vazhdim dhe kur shoqëria Brenda 2 vitet e para pas rregjistrimit të saj , propozon të blejë nga një ortak pasuri, që kanë vlerën 5 % të aseteve të shoqërisë , që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.

Administratoret kanë të drejtë të kryejë të gjitha veprimet e administrimit të zakonshëm e të jashtëzakonshëm. Administratorët përfaqësojnë shoqërinë përpara të gjithë personave fizikë dhe juridik ,

Publike dhe/ose private venas ose të huaja, autoriteteve Shqipëtare ose të huaja, përfshi këtu marrdhënie me të tretët në emër të shoqërisë, në të gjitha rrethanat me përjashtim të kompetencave që ligji ia jep shprehimisht ortakëve të shoqërisë.

Administratorët angazojnë shoqërinë në marrdhënie me të tretët nëpërmjet akteve që janë në përputhje me objektin e saj .

Shoqëria nuk merr përsipër pasojat ndaj të tretëve kur ajo provon se të tretët i dinin që akti i administratorit e kalonte objektin e shoqërisë ose kur të tretët nuk mund ta injoronin këtë akt në rrethanat e dhëna , duke patur parasysh faktin se vetëm shpallja e statutit nuk është provë e mjaftueshme .

NENI 12

Përgjegjësitë

Administratorët janë përgjegjës individualisht, ndaj shoqërisë ose ndaj të tretëve , për shkeljen e ligjeve, për shkeljen e statutit, apo për faje të kryera gjatë administrimit të shoqërisë .

Pasojat e marreveshjeve të pamiratuara nga Ortaket që i sjellin dëm shoqërisë, i ngarkohen administratorit ose subjektit që ka bërë marrveshjen, për të përballuar në menyrë individuale ose solidarisht sipas rastit pasojat përkatëse

Përvec sa është parashikuar në dispozitat e përgjithëshme të detyrimit të besnikërisë , sipas neneve 14,15,17e 18 të ligjit “Për Tregëtarët dhe Shoqërite tregëtare” administrator detyrohet:

- a) Të kryejë detyrat e tij të përcaktuara në ligj dhe në statut në mirëbesim e në interesin e më të mirë të shoqërisë në tërësi , duke i kushtuar vëmëndje të vecantë ndikimit të veprimtarisë së shoqërisë në mjedis ;
- b) Të ushtrojë kompetencat që i njihen me ligj dhe në statut vetëm për arritjen e qëllimeve të përcaktuara në këto dispozita;
- c) Të vlerësoj me përgjegjesi ceshtjet , për të cilat merret vendim;
- d) Të parandalojë dhe mënjanoj rastet e konfliktit , present apo të mundshëm , të interesave personal me ata të shoqërisë;

- e) Të ushtrojë detyrat e tij me profesionalizem dhe kujdesin e nevojshem .
- f) Administrator , gjatë kryerjes së detyrave të tij, përgjigjen ndaj shoqërisë për çdo veprim ose mosveprim , që lidhet në mënyrë të arsyeshme me qëllimet e shoqërisë tregëtare me përjashtim të rasteve kur në bazë të hetimit dhe vleresimit të informacioneve përkatëse veprimi ose mosveprimi është kryer në mirëbesim .

3) Nëse administratori vepron në kundëshim me detyrat dhe shkel standartet profesionale sipas pikave 1 dhe 2 të këtij neni është i

Detyruar t'i dëmshperblejë shoqërisë dëmet, që rrjedhin nga kryerja e shkeljes, si dhe t'i kalojë çdo përfitim personal që ata apo personat e lidhur me ta kanë realizuar nga keto veprime të parregullta. Administratori ka barrën e provës për të vërtetuar kryerjen e detyrave të tyre në mënyrë të rregullt e sipas standarteve të kërkuara. Kur shkelja e kryer nga më shumë se një administrator , ata përgjigjen ndaj shoqërisë në mënyrë solidare .

4) Në mënyrë të vecantë , por pa u kufizuar për to, administratori është i detyruar ti dëmshperblejë shoqërisë dëmet e shkaktuara , nese , në , kundëshim me dispozitat ligjore , “Për Tregëtarët dhe Shoqëritë Tregëtare , kryen veprimet e mëposhtme:

- a) U kthen ortakeve kontributet ;
- b) U paguan ortakëve interesa apo dividente ;
- c) U shpërndan aktivet shoqërisë;
- d) Lejon që shoqëria të vazhdojë veprimtarinë tregëtare ,kur , në bazë të gjëndjes financiare , duhej të parashikohej që shoqëria nuk do të kishte aftësi paguese për të shlyer detyrimet;
- e) Jep kredi.

Neni 13

Viti Financiar

Viti Financiar i shoqërisë fillon me 1 janar dhe perfundon ne 31 dhjetor. Perjashtimisht, viti i pare Financiar fillon nga data e regjistrimit te shkoqerisë ne QKB dhe mbyllet ne 31 dhjetor.

Neni 14

Bilanci i shoqërisë dhe dividendet

Brenda 6 muajsh nga mbyllja e vitit financiar, me vendim te Asamblese se ortakeve, miratohet bilanci i paraqitur nga Administratori.

Ortakët vendosin rreth shpërndarjes së dividendit, pasi të jenë zbritur humbjet e vitit të mëparshëm financiar, sic parashikohet nga ligji.

Neni 15



Ekspertet

Ekspteri ka për detyrë që të kontrollojë të gjithë dokumentacionin kontabel të veprimtarisë ekonomiko tregtare të shoqërisë,atë gjithëvjetor dhe atë në lidhje me kontrollet periodike të ushtruara prej tij për rastet kur ai është ngarkuar dhe ka kryer një gjë të tillë i ngarkuar nga ana e asamblesë së ortakëve.

Ne përfundim të kontrollit eksperti kontabël i autorizuar përgatit raportin me shkrim për nxjerrjen e rezultatit të bilancit financiar vjetor si dhe për atë për kontrollet periodike të ushtruara,të cilat është i detyruar që t ia paraqesë e dorëzojë në kohë asamblesë së ortakëve për ti shqyrtuar e miratuar mbi bazën e të drejtës vendimore që ka.

Neni 16

Të ardhurat neto(dividenti) që mbeten pas veçimit të fondeve ligjore të mësipërme dhe të atyre për shlyerjen e çdo detyrimi fiskal apo likuidimin e pagesave ndaj të tretëve,i mbeten dhe i kalojne në pronësi, ortakëve te shoqërisë.

Neni 17

Shpërnarja ose prishja e shoqërisë mund të bëhet në çdo kohë:

- a) kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në themelimin e saj;
- b) me vendim të ortakëve;
- c) me hapjen e procedurave të falimentimit;
- ç) nëse nuk ka kryer veprimtari tregtare për dy vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i veprimtarisë në perputhje me pikën 3 të nenit43 të ligjit nr.9723,datë 3.05.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”;
- d) me vendim të gjykatës;

Në këtë rast asambleja merr vendim me shkrim në të cilin parashikon mënyrën e likuidimit të shoqërisë,duke caktuar 1 apo disa likuidatore dhe shënuar në çdo dokument të nxjerrë prej tij emrin e likuidatorit dhe emërtesën shtesë “Shoqëri në likuidim e sipër”.

Prishja e shoqërive tregtare ka si pasojë hapjen e procedurave të likuidimit në gjëndjen e aftësisë paguese,me përjashtim të rasteve kur është nisur një procedurë falimentimi.

Likuidimi kryhet nga likuiduesit e emëruar nga Ortaket themelues.

Nëse ortaket nuk marrin një vendim për emërimin e likuiduesve,brenda 30 ditëve pas prishjes, çdo person i interesuar mund t i drejtohet gjykatës,për të caktuar një likuidues.

Neni 18



Likuiduesi merr përsipër të drejtat dhe detyrimet e administratorëve nga data e emërimit të tij. Nëse shoqëria emëron më shumë se një likuidues, përveçse kur akti i emërimit përqashikon se ata veprijnë veçmas njerëjtjetrit, likuiduesit ushtrojnë bashkërisht të drejtat e detyrimet sipas këtij ligji. Likuiduesit mund të autorizojnë njërin prej tyre të kryejë veprime të një kategorie të posaçme. Kufizimet e tagrave të likuiduesve u kundrejtohen të tretëve, në përputhje me përcaktimet e ligjeve. Likuiduesi i nënshtrohet mbikeqyrjes së ortakëve dhe administratorit.

Neni 19

Të drejtat e detyrimet e likuiduesit

1. Detyra e likuiduesve është mbyllja e të gjitha veprimeve të shoqërisë, mbledhja e kredive të paarkëtuara dhe e kontributeve të pashlyera, shitja e pasurive të shoqërisë dhe shlyerja e kreditorëve duke respektuar radhën e referimit, sipas nenit 605 të Kodit Civil.
2. Nëse, në bazë të padive të ngritura nga kreditorët, sipas nenit 194 të ligjit "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", likuiduesit vërejnë se pasuria shoqërisë tregtare, përfshin detyrimin e pashlyera, nuk është e mjaftueshme për pagesën e këtyre pretendimeve, likuiduesit ta pezullojnë procedurën e likuidimit e ti kërkojnë gjykatës përkatëse nisjen e fazës së falimentimit.

Likuiduesi përgatit një bilanc të gjëndjes së shoqërisë në çastin e hapjes së likuidimit përfundimtar në çastin e mbylljes së këtyre procedurave. Nëse procedura e likuidimit zgjat më shumë se një vit, likuiduesi përgatit, gjithashtu, pasqyrat financiare vjetore të shoqërisë. Bilancet kolektive dhe komanditë miratohen nga ortakët e tjerë, ndërsa në shoqëritë aksionare ata kanë përgjegjësi të kufizuar miratohen nga asambleja e përgjithshme.

Neni 20

Perfundimi i likuidimit

Pas shpërndarjes së aktiveve të mbetura, likuiduesi e njofton Qendrën Kombëtare të Biznesit përfundimin e likuidimit dhe kërkon çregjistrimin e shoqërisë, në përputhje me seksionin nr.9723, datë 3.05.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit".

Neni 21

Bashkimi

Dy ose më shumë shoqëri mund të bashkohen nëpërmjet:

1. Kalimit të të gjitha aktiveve dhe pasiveve të njëres ose më shumë prej shoqërive që quhen shoqëri të perthithura, të një shoqërie tjetër ekzistuese, e quajtur shoqëria përthithëse, në këmbim të aksioneve dhe kuotave të kësaj shoqërie. Ky proces quhet bashkim me perthithje.

2. Themelimit të një shoqërie të re, tek e cila kalon të gjitha aktivet e pasivet e shoqërive ekzistuese që bashkohen në këmbim të aksioneve apo kuotave të shoqërisë së re. Ky proces quhet bashkimi i një krijimi të një shoqërie të re.

Neni 22



Ndarja

1. Nje shoqëri mund të ndahet me vendim të Ortakëve, duke transferuar të gjitha aktivet e pasivet e veta në favor të dy ose më shumë shoqërive ekzistuese apo të themeluara rishtazi. Shoqëria që ndahet vlerësohet e prishur.

2. Për ndarjen e shoqërisë zbatohen përkatësisht dispozitat e neneve 216 deri në 225 të ligjit 9901 datë 14.04.2008..

3. Shoqëritë, që fitojnë pasuritë e shoqërisë që ndahet, quhen shoqëri pritëse dhe përgjigjen në mënyrë solidare për detyrimet e kësaj të fundit.

4. Regjistrimi i ndarjes së shoqërisë pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit ka si pasojë kalimin të shoqëritë pritëse të të gjitha aktiveve e pasiveve të shoqërisë që ndahet, në përputhje me raportin e ndarjes, të përcaktuar në marrëveshjen e ndarjes. Ky kalim sjell pasoja për marrëdhëniet ndërmjet shoqërive, si dhe për palët e treta; bërjen e aksionarëve/ortakëve të shoqërisë që ndahet aksione apo ortakë të një ose më shumë shoqërive pritëse, në përputhje me raportin e ndarjes përcaktojnë marrëveshjen e ndarjes, vlerësimin e shoqërisë që ndahet si e prishur dhe rregjistrimin e saj nga Qendra Kombëtare e Rregjistrimit, sipas seksionit V të ligjit nr . datë 3.05.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Rregjistrimit” pa kryerjen e likuidimit.

Neni 23

Shndërrimi

Shoqëria mund të ndryshojë formën e vet ligjore, nepermjet shndërrimit të saj në shoqëri aksionere. Shoqëria nuk sjell pasoja mbi të drejtat e detyrimet, që shoqëria ka marrë përsipër ndaj të treta .

Neni 24

Baza ligjore

Shoqëria do të zhvilloj aktivitetin e saj në përputhje të plotë me këtë status dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar. Për sa nuk parashikohet në këtë statut, do të zbatohen dispozitat e ligjit “Për tregëtarët dhe shoqëritë tregëtare” Kodit Civil dhe dhe çfardo ligjit tjetër specifik në Republikën e Shqipërisë

Neni 25

Mosmarrveshjet

Për mosmarrveshjet që mund të lindin në lidhje me zbatimin apo interpretimin e këtij statuti, si dhe për çdo mosmarrëveshje që mund të lindin midis Shoqërisë dhe të treta, do të jetë kompetente Gjykata Shqiptare .

Neni 26

Dispozita përfundimtare

Ky Statut u redaktua në 4 ekzemplar me vlera të njëjta juridike në gjuhën shqipe dhe pasi u lexua nga ortakët, nënshkruhet me vullnet të lirë dhe të plotë.



ORTAKET E SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR

EMERTIMI I SHOQERISE "St. Luis Watersports" Shpk

Luis Xhumari

A handwritten signature in blue ink, appearing to read "Luis Xhumari".A stylized handwritten mark or signature in blue ink, possibly a monogram or a specific signature.